**AKTI I THEMELIMIT**
**I**
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"Fagu" Sh.p.k.**

**Neni 1**
**Ortaket themelues**

Sot me date 30.5.2003 personi ne vijim

Z. Sajmir Fagu, shtetas shqiptar, lindur ne 15.11.1966, banues ne Tirane, ne Rruga: Q.Stafa, pall: 66, shk: 1, ap: 5, mbajtes i pasaportes me Nr:Z 0146655;

**Neni 2**
**Emertimi**

Shoqeria emertohet "Fagu" sh.p.k.

**Neni 3**
**Forma dhe Baza ligjore**

Shoqeria eshte e formes me pergje
gjesi te kufizuar (sh.p.k), ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare".

Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e duhur te Ortakut te vetem.

Shoqeria "Fagu" sh.p.k., do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut, ligjin nr. 7638 date 19 Nentor 1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit 7667, dt 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare",si dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar.

**Neni 4**
**Kohezgjatja**

Veprimtaria e Shoqerise do te filloje pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit te Tiranes. Veprimtaria e shoqerise do te zgjase per nje afat te pa kufizuar kohe, me perjashtim te rastit te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara ne ligj ose me vendim te ortakut te vetem.

## Neni 5
## Selia

Selia e shoqerise eshte ne Rrugen "Autostrada Tirane-Durres, kilometri 4, Komuna Kashar" Tirane.

Shoqeria ka te drejte te krijoje dege, filiale ose / dhe zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, dhe jashte vendit.

## Neni 6
## Objekti

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Shitje dhe blerje te automjeteve dhe mjeteve motorike, auto-servis te te gjitha tipeve, pjese kembimi te te gjitha llojeve si dhe kontroll te pergjithshem te te gjitha mjeteve motorike.

Objekti i shoqerise mund te zgjerohet ose ndryshoje me vendim te ortakut te vetem.

## Neni 7
## Kapitali

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) leke, teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku I vetem perpara regjistrimit te shoqerise ne Gjykate.

Kapitali eshte ndare ne 20 (njezet) pjese, secila me vlere nominale 5000 leke (pesmije), te renditura sipas numrit te series nga 1 ne 20.
Pjeset e kapitalit zoterohen nga ortaku I vetem.

## Neni 8
## Ortaku I Vetem. Komprtencat

Vendimet kryesore merren nga Ortaku I vetem, si organ I vetem drejtues I shoqerise. Ai miraton llogarite nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar, Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.Ortaku I vetem mund te delegoje kompetencat e tij. Vendimet e tij te marra ne vend te asamblese evidentohen ne regjister.

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator, z.Sajmir Fagu.

## Neni 9

**Eksperti Kontabel I Autorizuar**

Eksperti (ekspertet) kontabel i autorizuar do te caktohen me vendim te marre nga ortaku I vetem ne rast se do te permbushen dy prej tre kushteve te percaktuara nga ligji.

Eksperti (ekspertet) kontabel i autorizuar do te qendroje ne detyre per nje periudhe 6 vjecare.

**Neni 10**
**Viti Financiar**

Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar ne 1 janari dhe mbaron me 31 dhjetor. Si perjashtim, viti i pare i veprimtarise se shoqerise dhe do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise prane organeve tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 2003.

**Neni 11**
**Bilanci. Mbajtja E Kontabilitetit**

Bilanci mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti, ku I pari do te jete 31 dhjetori I vitit 2003. Llogarite vjetore, inventari raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel I autorizuar nga ortaku, miratohen nga ortaku I vetem.
Miratimi I dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet Brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar

**Neni 12**
**Te Ardhurat. Dividenti**

Shoqeria do te krijoje fonde rezerve per realizimin e objektit te saj.

Ortaku I vetem miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit.Ai percakton fitimin e vitit financiar, te cilit I jane zbritur shumat e lena menjane per:rezerven sipas ligjit ose te percaktuar nga vete ortaku, fondet e tjera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tjeter jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet ose fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme. Keshtu ortaku I vetem percakton dhe dividentin.

**Neni !3**
**Likujdimi**

Shoqeria do te hyje ne procesin e likujdimit, nese:

- gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
- Ortaku I vetem vendos te prishe shoqerine.

Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likujdimit, Ortaku I vetem emeron nje likuidator ose nje grup likuidatoresh,

**Neni 14**
**Zgjidhja e Mosmarveshjeve**

1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, palet i drejtohen per zgjidhje gjykates se Tiranes.

**Neni 14**
**Klauzola Mbyllese**

Ky Akt themelimi hartohet ne 4 ekzemplare, ne gjuhen Shqipe secili me vlere te njejte ligjore.

**O R T A K U   I  V E T E M**

**Sajmir Fagu**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 358 REP.
NR. 214 KOL.

NOTER TIRANE

**VERTETIM**

Sot, me date 03.06.2003, para meje, Arian Merkuri, noter i Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht:

Z. Sajmir Fagu, I biri I Selimit dhe Diletes, I dtl: 15.11.66, lindur e banues ne Tirane, ne adresen: Rr Qemal Stafa, pall 66, shk 1, ap 5.

Personi eshte madhor, me zotesi per te vepruar dhe tagra perfaqesimi, i cili deklaron se kete **Akt Themelimi** e ka perpiluar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe ne perputhje me ligjin
Per Shoqerite Tregtare.

Une noteri, pasi e lexova tekstin e ketij **Akt Themelimi** me ze te larte dhe ortaku e nenshkruan ate rregullisht para meje, vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

NOTERI
ARIAN A. MERKURI

**STATUTI**
**I**
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"Fagu" Sh.p.k.**

## THEMELIMI

**Neni 1**
**Ortaku I vetem**

Shoqeria "Fagu" Sh.p.k themelohet nga ortaku I vetem:

Sajmir Fagu, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 15.11.1966, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes me Nr. Z 0146655

## II. EMERTIMI. SELIA. FORMA LIGJORE

**Neni 2**
**Emertimi**

Shoqeria emertohet "Fagu" sh.p.k.

**Neni 3**
**Forma ligjore**

Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k), ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare".

Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e duhur te Ortakeve.

**Neni 4**
**Baza ligjore**

Shoqeria "Fagu" sh.p.k., do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut, ligjin nr. 7638 date 19 Nentor 1992 "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar.

**Neni 5**
**Kohezgjatja**

## Neni 9
## Kapitali

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) leke, teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaket perpara regjistrimit te shoqerise ne Gjykate.

Kapitali eshte ndare ne 20 pjese (njezet), secila me vlere nominale 5.000 leke (pese mije), te renditura sipas numrit te serise nga 1 ne 20.

## Neni 10
## Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen vetem me akt noterial.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme nga ortaku I vetem I shoqerise.

Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen edhe te treteve, por pasi ortaku I vetem vendos per kete .

Pjeset e kapitalit transferohen automatikisht ne rruge trashegimie. Bashkshortja, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltare me vendim te ortakut te vetem sipas kushteve qe lejon ligji.

## Neni 11
## Zmadhimi i kapitalit themeltar

Ortaku I vetem mund te shtoje ose zvogeloje kapitalin ne varesi te nevojave dhe rezultateve te aktivitetit te shoqerise.

## Neni 12
## Zvogelimi i kapitalit themeltar

Zvogelimi i kapitalit do te behet sipas procedurave te parashikuara ne ligjin "Per shoqerite tregtare".

Projekti i zvogelimit i paraqitet ekspertit kontabel te autorizuar ose administratoreve, Eksperti kontabel i autorizuar ose administratoret shqyrtojne projektin dhe i paraqesin ortakut te vetem raportin lidhur me shkaqet dhe kushtet e zvogelimit te kapitalit themeltar.

Raporti i zvogelimit miratohet ne menyre te shprehur me vendim nga ortaku I vetem.

## ORGANET E SHOQERISE

### Neni 13
### Ortaku I Vetem

Si organ I vetem drejtues I Shoqerise eshte ortaku I vetem.Ai miraton llogarite, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar, Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.Ortaku I vetem mund te delegoje kompetencat e tij. Vendimet e tij te marra ne vend te asamblese,evidencohen ne nje regjister.

### Neni 14
### Kompetencat e Ortakut te Vetem

Ortaku I vetem, vendos per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise dhe perpilon ose miraton rregulloret per Shoqerine apo per sektore te vecante te veprimtarise.

Vendos per politiken afariste te Shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.

Emeron dhe shkarkon administratoret e Shoqerise dhe detajon kompetencat e tyre te percaktuara ne Statut.

Shqyrton bilancin vjetor,percakton llojet e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, Fitimin e realizuar si dhe vendos marrjen e kredive

Vendos per krijimin e degeve (filialeve) ose perfaqesive si dhe per krijimin e Shoqerive me persona te tjere fizik apo juridike.

Vendos per mbarimin e Shoqerise, likujdimin e saj si dhe per shnderrimin e Shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera.

Pervec kompetencave te lartpermendura, te cilat jane ekskluzive per te,ortaku I I vetem kryen dhe kompetenca te tjera te ngarkuara nga ligji apo statuti.

### Neni 15
### Administratori dhe Kompetencat e Tij

Kompetencat e administratorit ose te administratoreve, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Vec te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, administratori ka dhe keteo kompetenca:

Kujdeset per funksionimin e perditshem normalte Shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit

ekonomik financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.

Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet ortakut te vetem per shqyrtim.

Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri.

Shqyrton ofertat dhe pergatit kerkesa te cilat ia paraqet ortakut te vetem per miratim.

Ndjek problemet e Shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.

I propozon ortakut te vetem cmimet e shitjes dhe te sherbimeve si dhe pagat per personelin e punesuar ne Shoqeri.

I propozon ortakut te vetem rregulloret per sektore te vecante te Shoqerise.

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te Statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.

Administrator I Shoqerise eshte Z.Sajmir Fagu.

**Neni 16**
**Eksperti kontabel i autorizuar**

Eksperti (ekspertet) kontabel i autorizuar do te caktohen me vendim te marre nga Ortaku I vetem.

Eksperti (ekspertet) kontabel i autorizuar do te qendroje ne detyre per nje periudhe 6 vjecare.

**Neni 17**
**Viti financiar**

Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar ne 1 janari dhe mbaron me 31 dhjetor.

Si perjashtim, viti i pare i veprimtarise se shoqerise dhe do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise prane organeve tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 2003.

**Neni 18**
**Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit**

Bilanci vjetor i Shoqerise shqyrtohet nga ortaku I vetem dhe duhet te hartohet per tiu paraqitur organeve tatimore.

Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe ne monedhen Shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute te cilat do te konvertohen cdo muaj ne monedhe shqiptare.

Shoqeria mund te marre financime nga ortaku I vetem, institucione financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te vendose si garanci pengun mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Ortakut te vetem.

**Neni 19**
**Te ardhurat. Dividendi**

Shoqeria do te krijoje fonde rezerve per realizimin e objektit te saj.

Ortaku I vetem miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit.Ai percakton fitimin e vitit financiar, te cilit I jane zbritur shumat e lena menjane per:

Rezerven sipas ligjit ose te percaktuar nga vete ortaku, fondet e tjera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tjeter jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet ose fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme. Keshtu ortaku I vetem percakton dhe dividentin.

**Neni 20**
**Likuidimi**

Shoqeria do te hyje ne procesin e likujdimit, nese:

- gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
- Ortaku I vetem vendos per prishjen e Shoqerise.

Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likujdimit, Ortaku I vetem emeron nje likuidator ose nje grup likuidatoresh,

Likuidatori/likuidatoret do te raportojne mbi gjendjen e zerave te aktivit dhe te pasivit te shoqerise rreth operacioneve te metejshme te likuidimit dhe kohen qe nevojitet per perfundimin e tij. Ne fund te ketij procesi, Ortaku I vetem shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedures se likuidimit.

**Neni 21**
**Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, palet i drejtohen per zgjidhje gjykates se Tiranes.

**Neni 22**
**Klauzola mbyllese**

Ky statut hartohet ne 4 ekzemplare, ne gjuhen Shqipe secili me vlere te njejte ligjore.

Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles do te percaktohen nga ortaku I vetem.

**ORTAKU I VETEM**